

**INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTORI
 OVERDRAFTIT/KREDISE HIPOTEKARE TE SIGURUAR ME
 KOLATERAL**

Prezantim	Ky informacion përbën një prezantim të ofertës që Banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut. Ky informacion nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Dhënia e informacionit sipas këtij dokumenti nuk parasheh detyrimin e Bankës për të akorduar kredi.
1. Banka	“Banka e Pare e Investimeve”, ALBANIA Sh.a Adresa: Bulevardi “Deshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tiranë. Adresa e Web-it: www.fibank.al Telefono pa pagese 080001111; Tel 042276702/3; Fax: 042280210
2. Emri i Produktit	Overdraft/Kredi Hipotekare
3. Qëllimi i produktit, afati dhe monedha	Overdrafti/Kredia hipotekare që jepet nga FIBANK sha ka si qëllim plotësimin e kërkesave dhe nevojave financiare të klienteve individ apo dhe Personave Fizike me deklaram vjetor nën 14 mio lekë të cilët duan të blejnë, ndërtojnë, rikonstruktojnë, rregullojnë shtëpi, etj. Ky produkt do të përfitohet nga individë me të ardhura neto familjare mbi 200’000 Leke në muaj dhe të ardhura nga biznesi mbi 2’400’000 Leke në vit. Shuma maksimale e kredise është 85% e vlerës së tregut të kolateralit Afati maksimal deri në 300 muaj (deri në 60 muaj ofrohet regjim overdrafti) Monedha : Lekë; EUR
4. Përshkrimi i produktit	Kredia/Overdraft hipotekor është një produkt kredie afatgjate. Kjo kredi është e pagueshme me regjim overdrafti deri në 5 vitet e para dhe pas këtij afati kredi me keste të barabarta mujore. Gjate periudhes se regjimit te overdraftit paguhet vetem interesi mujor mbi shumën e përdorur të këtij overdrafti dhe me pas, shumën debitorë të overdraftit do të kthehet në kredi dhe do të ripaguhet me këste të barabarta mujore të perbera si me poshte: (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes.
5. Garanci/siguri të nevojshme	Sende të hipotekueshme janë pasuritë e paluajtshme, si ndërtesat, toka me dokumenta të rregullta dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën. Prona e hipotekueshme mund të jetë e ndryshme nga objekti i kredisë. Garancia do të vlerësohet sipas procedurës standarde të bankës dhe vlerësuesve të aprovuar nga banka dhe duhet të ketë raportet e mbulimit si me poshte: <ul style="list-style-type: none"> • Klienti bleres/zoterues për here të pare i një prone rezidenciale dhe kredia në leke, maksimumi i financimit duhet të jete 85% i vlerës së kolateralit të ofruar • Klienti bleres/zoterues i pronës së dyte rezidenciale (pra nëse klienti ble/zoteron shtëpi të dyte dhe vijuese ose qëllimi i kredisë është investim) dhe kredia në leke, maksimumi i financimit duhet të jete 80% i vlerës së kolateralit të ofruar • Klienti bleres/zoterues për here të pare i një prone rezidenciale dhe kredia në Euro, maksimumi i financimit duhet të jete 75% i vlerës së kolateralit të ofruar

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none">• Klienti blyer/zoterues i prones se dyte rezidenciale (pra nese klienti ble/zoteron shtepi te dyte dhe vijuese ose qellimi i kredise eshte per investim) dhe kredia ne Euro, maksimumi i financimit duhet te jete 70% i vleres se kolateralit te ofruar• 85% te vleres se kolateralit kur financojme blyerjen e nje pasurie te paluajtshme tregtare dhe njekohesisht te siguar me nje pasuri te te njejtij lloj |
|--|---|

Raporti i vleresimit te pasurive te paluajtshme kryhet nga vleresues te pavarur te sygjieruar nga banka dhe kjo kosto mbulohet nga aplikanti.

6. Norma e Interesit

LEKË :

2.99% vitin e parë; Bono Thesari 12M + 1.99%, jo më pak se 3.99% per vitet ne vazhdim

EUR:

1.99% vitin e parë; Euribor 12M + 2.49%, jo më pak se 4.99% per vitet ne vazhdim

**Bazuar ne vleresimin e riskut te rastit, norma e interesit mund te rritet deri ne 3%. Disa faktore qe mund te ndikojne ne kete rritje jane:

- Te ardhura jo te diversifikuara
- Vendndodhja e kolateralit ne fshat ose qyetete ku Fibank nuk eshte prezent
- Kolaterali ka likuiditet te ulet ose eshte toke
- Nuk ka garantor

Pergjate regjimit te overdraftit:

Interesi llogaritet çdo ditë dhe do të paguhet çdo fund muaji mbi balancën debitore të llogarisë rrjedhëse të kredisë me kufi (overdraft), duke filluar nga dita e parë e përdorimit të kredisë me kufi (overdraft) në bazë të shumës së perdorur. Interesat përkatëse dhe shumat e tjera të detyrueshme për Huamarrësin do të llogariten në bazë të ditëve efektive, duke pranuar vitin me 360 ditë.

Interesi = Limit i përdorur * N.interesit * Ditët e përdorura /360 ditë

Pergjate regjimit te kredise:

6.1 Pagesat e interesit të përcaktuara në planin e shlyerjes përlllogaritet mbi principalin e kredisë në bazë të EURIBOR-it vjetor/ Bonove 12 mujore të thesarit në momentin kur do të nënshkruhet kontrata dhe nuk pasqyron masën e plotë të interesit të detyruar për cdo periudhë interesi por ka karakter orientues.

6.2 Banka përlllogarit cdo ditë interesin real të detyruar mbi pjesën e pashlyer të kredisë. Interesi real i detyruar përlllogaritet në bazë të EURIBOR-it vjetor/ Bonove 12 mujore të thesarit i publikuar, për ditën përkatëse të llogaritjes plus shtesat si më sipër.

Banka mbledh ose kthen diferencen ndërmjet interesit të llogaritur midis pikës 6.1 dhe 6.2 ne rastet kur:

- Në datën e maturimit të pagesës së fundit të interesit të përcaktuar në planin e shlyerjes
- Në rast të ridiskutimit të kushteve të kontratës së kredise me Kredimarrësin
- Në rast të shlyerjes së pjesshme para afatit ose të shlyerjes se plote të detyrimeve të Kredimarrësit
- Banka me iniciativen e saj në datën e maturimit të pagesës së interesit të përcaktuar në planin e shlyerjes ; me iniciativen e saj në datën e maturimit të pagesës së interesit përkatës

Interesat përkatëse dhe shumat e tjera të detyrueshme për Huamarrësin do të llogariten në bazë të diteve efektive, duke pranuar vitin me 360 ditë

Normat Eur 12m/Bono Thesari 12 M jane te publikuar ne faqen LIBOR te REUTERS ne ditën qe i korrespondon 12 muaj pas dates se disbursimit te kredise/norma baze e interesit e publikuar ne faqen zyrtare te Bankes se Shqipërisë ne ditën qe i korrespondon 12 muaj pas dates se disbursimit te kredise.

<p>7. Norma efektive e interesit (NEI)</p>	<p><u>Pergjate regjimit te overdraftit:</u> Është totali i koston së kredisë me kufi (overdraft) për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e limitit të kredisë me kufi (overdraft) të dhënë dhe e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare financiare”, e bazuar ne supozimin që kontrata e kredisë që do të firmoset është e vlefshme për afatin kontraktor dhe palët përmbushin rregullisht detyrimet sipas kushteve dhe mënyrës së rënë dakord në kontratë.</p> <p><u>Pergjate regjimit te kredise:</u> Është totali i koston së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e limitit të kredisë të dhënë dhe e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së Bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare financiare”.</p> <p>Për qëllime të llogaritjes së NEI totali i koston së kredise nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes së NEI: shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tretë(psh pagesat noteriale, bllokimit, etj) dhe cdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë apo shpenzime për ndryshim të kushteve kontraktore. NEI do të llogaritet me supozimin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrata është e vlefshme për periudhën e rene dakord dhe • Palet plotesojnë detyrimet e tyre sipas kushteve dhe datës së rene dakord në kontratën e kredisë dhe • Përqindja e interesit dhe shpenzimet e tjera që përfshihen në llogaritjen e NEI mbeten të pandryshuara deri në fund të kontratës së kredisë
<p>8. Afati maksimal dhe monedha e kredisë</p>	<p>Afati maksimal: 25 vjet (deri ne 5 vjet regjim overdrafti)</p> <p>Lekë; Euro</p>
<p>9. Vlera e kredisë dhe monedha ne cilen kerkohet</p>	<p style="background-color: yellow; height: 20px; width: 100%;"></p>
<p>10. Kohezgjatja e kontrates se kredise</p>	<p style="background-color: yellow; width: 50px; display: inline-block;"></p> muaj
<p>11. Plani i amortizimit</p>	<p><u>Pergjate regjimit te overdraftit:</u> Interesi paguhet çdo fund muaji i llogaritur për shumën dhe ditët e përdorura. Principali mund të paguhet në çdo moment i plotë ose i pjesshëm sipas dëshires së klientit. Principali = Limiti i përdorur</p> <p><u>Pergjate regjimit te kredise:</u> Numri dhe frekuenca e pagesave = keste te barabarta mujore</p> <p>Vlera e cdo kesti = </p> <p>NEI = _____ %</p> <p><i>Pëllogaritja e NEI-t është pjesë integrale bashkangjitur këtij dokumenti.</i></p>

12. Nëse është e aplikueshme Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat.	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ne monedhe te ndryshme nga te ardhurat ○ Ne te njejten monedhe me te ardhurat
13. Nëse është e aplikueshme Vlera e këstit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.	<p>Ju do të merrni një njoftim në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, si psh</p> <p>kësti i kredisë [50.000 lek] tejkalon vlerën [60.000 lek] nese te ardhurat jane ne lek kredia ne euro</p> <p>kësti i kredisë [400 euro] tejkalon vlerën [480 euro] nese te ardhurat jane ne euro kredia ne lek</p> <p>Ju do të keni mundësinë të konvertoni kredinë në monedhen ne te cilen keni te ardhurat nëse</p> <p>si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë rritet me shume se 20% sesa kundërvlera e këstit që do të rezultonte nëse do të aplikohet kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Konvertimi mund të kryhet bazuar në rezultatet e analizës apo të vlerësimit më të fundit të bankës, mbi monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat</p>
14. Shuma totale qe konsumatori do te kete per te paguar	<p>Shuma e totalit te kredise = [redacted] [redacted]</p> <p>(Vlera e Kryegjese + Vlera e Interesit + Vlera e Komisionit te manaxhimit te kredise + Vlera e komisionit te aplikimit + Vlera e mbajtjes se komisionit te llogarise + Shpenzime noteriale + Shpenzime Hipotekore + Kosto e Vleresimit te Kolateralit + Kosto Sigurimi Kolaterali)</p>
15. Tërheqja e fondeve	<p>Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Me ane të tërheqjes në të holla 2.Me ane të urdher pageses së dhënë me shkrim në favor të të tretëve 3.Me ane të mjeteve elektronike 4.Sipas mënyrës së rëne dakort në kontratë <p>Kur banka konstaton së Kredimarresi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e kredisë nënshkruar nga palet, Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e menjehershëm të shumës së kredisë dhe të gjithë detyrimeve të lidhura me të përmes një njoftimi me shkrim nga ana e bankës.</p>
16. Kosto shtesë e detyrueshme për përfitimin e kredisë	<ul style="list-style-type: none"> • Komision aplikimi: [redacted] [redacted] • Komision menaxhimi: [redacted] % mbi shumën e disbursuar te overdraftit dhe [redacted] % kur shuma debitore e overdraftit do te kthehet ne kredi • Vleresimi i pronës: [redacted] • Kosto noterizimi: <ul style="list-style-type: none"> ➢ Kontrata e kredise: [redacted] Leke ➢ Kontrata e hipotekes: [redacted] Leke • Kosto bllokimi prone në hipotekë: [redacted] Leke <p>Këto shpenzime jane të pashmangshme dhe ekzekutohen vetëm një here.</p>

17. Shlyerje para afatit të maturimit	<p><u>Pergjate regjimit te overdraftit:</u> Klienti ka të drejtë të kryejë në cdo kohe, para afatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë pa asnjë komision.</p> <p><u>Pergjate regjimit te kredise:</u></p> <p>Banka do të pranojë mbyllje të parakohshme të huasë, të pjesshme apo totale të principalit përkundrejt një pagese prej</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2% e shumës së paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi një vit • 1% e shumës së paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon një vit
18. Kosto shtesë te tjera	<p>Në rast të aprovimit të aplikimit për kredi klienti duhet të paguajë kosto të tjera shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurim prone: Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme përpara disbursimit të kredisë. Primet e policave të sigurimit të pronës përsëriten cdo vit. • Kosto e mbajtjes së llogarisë: Për celjen e llogarisë së kredisë dhe për transaksionet që do të kryhen me këtë llogari lidhur me lëvrimin e kredisë dhe kryerjen e pagesave për ripagimin e kredisë, Banka do të aplikojë komisionet në masën prej 100 lekë/1 EUR ne muaj . Në rast Personi Fizik, komisionet janë 150 lekë/1 Eur.
19. Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)	<p>Klienti ka te drejte te kerkoje zevendesimin e kolateralit nese ploteson kushtet e meposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në momentin e kërkesës për një periudhë prej 6 muajsh para saj, të mos ketë status kredie ose vonese në regjistrin e kredisë si kreditor primar ose si palë e lidhur - Në FiBank mos të ketë detyrim të papaguar për kreditë e veta ose si palë e lidhur - Prona qe do te ofrohet si kolateral i ri te jete rezidenciale me nje vlere tregu sipas rregullave ne fuqi te bankes ne momentin e kerkeses - Prona duhet te jete e hipotekueshme dhe duhet te plotesoje edhe kerkesat e dokumentacionit ligjor te kerkuar <p>* Vendimmarrja ne zevendesimin e kolateralit eshte subjekt aprovimi sipas rregullores te brendshme te bankes</p>
20. Nëse është e aplikueshme Produkte/shërbime shtesë:	<p>Informacion mbi produktet/shërbimet shtesë të ofruara nga banka: Kjo kredi është e lidhur me një llogari rrjedhese te klientit, llogari e cila ofrohet ne perputhje me termat dhe kushtet ne fuqi te Bankes ne daten e hapjes se saj</p>
21. Njoftimi zyrtar midis palëve	<p>Të gjithë njoftimet komunikimet midis paleve do të behen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë në adresën e përcaktuar në kontratën e kredisë ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (email, disket, CD ROM, DVD, kuti postare etj)</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar që për cdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 diteve kalendarike për këto ndryshime. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresen e re, kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bera në adresën e mëparshme.</p>

22. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga Kontrata e kredisë brenda një periudhe kalendarike 7 ditore nga dita e nënshkrimit të kontratës së kredisë. Perpara ushtrimit të kësaj të drejtë Kredimarrësi duhet të njoftojë Bankën brenda periudhës së sipërpërmendur. Në rast se Banka ka disbursuar shumën e kredisë Kredimarrësi është i detyruar të kthejë shumën e kredisë, interesat për ditët përkatëse si dhe shpenzimet e kryera nga Banka në funksion të disbursimit të kredisë
23. Ankimi	<ul style="list-style-type: none"> • Ankese me shkrim pranë cdo dege • Nëpërmjet telefonit: Telefono pa pagese 08000111 Tel 042276702/3 Fax: 042280210
24. Penalitete të tjera	<p><u>Pergjate regjimit te overdraftit:</u></p> <p>Në rast se kredimarrësi e kalon limitin e miratuar nga banka, ai do të paguajë interesin prej 36% i llogaritur mbi shumën me të cilën kalohet limiti i miratuar dhe kohën që është kaluar limiti.</p> <p>Nëse nuk janë siguruar mjetet financiare të nevojshme në ditën e përfundimit të afatit të paradhënies së akorduar, kredia me kufi (overdraft) konsiderohet si i palejuar. Pagesat e detyrueshme të pashlyera në afat për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë rrjedhëse të kredimarrësit në bankë, kalojnë në pagesë me kamatëvonesë me përqindje interesi në masën prej 36% mbi balancën debitore të llogarisë së kredimarrësit.</p> <p>Banka aplikon mbi shumën e tërë limitit të përdorur (principalit të pamaturuar) normën prej 1% pergjatë gjithë kohës që kredimarrësi do të jetë në shkelje dhe/ose mospërbushje të një prej detyrimeve që rrjedhin nga kontrata që do të firmoset mes palëve</p> <p><u>Pergjate regjimit te kredise:</u></p> <p>Në rast se kredimarrësi nuk përmbush detyrimet e parashikuar në kontratën që do të firmoset dhe /ose nuk ka siguruar fonde të mjaftueshme në llogarinë e tij për pagesën në kohë të këstit të kredisë, banka aplikon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. interesi sipas pikës 5 plus shtesën prej 20 (njetzet) njësisish.(Kryegjë në vonëse * {interes vjetor +20}/360*ditët në vonesë) 2. mbi shumën e tërë principalit të pamaturuar normen e interesit të pikës 5 plus shtesën prej 1% pergjatë gjithë periudhës që kredimarrësi do të jete në shkelje apo mospërbushje të një prej detyrimeve që rrjedhin nga kontrata që do të firmoset mes paleve
25. Kosto të tjera qe rrjedh nga kontrata e kredisë	Komision per ndryshim te kolateralit me kerkese te klientit, per ndryshime ne kontraten e kredisë është 0.25% e shumes se principalit te pamaturuar, jo me pak se EUR 50.
26. Periudha kohore e vlefshmërisë se informacionit	Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti

ANEKSI ME POSHTE ESHTË I VLEFSHEM VETEM PER ATA KLIENTE QE APLIKOJNE PËR KREDI NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO NË TË CILËN GJENEROJNE TË ARDHURAT

SHEMBULL ILUSTRUES PËR RREZIKUN E KURSIT TË KËMBIMIT PËR KREDINË NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE

Tekst sqarues për konsumatorin

Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit,

do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çonin në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë, në kthimin e kredisë në statusin “me probleme”, dhe mund të përfundonin në fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimit nga ana e bankës.

Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi.

Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se:

- 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë;
- 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit;
- 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.

Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë tek konsumatori, por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.

Të dhëna për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave

Kredimarrësi:

Kredidhënësi: FiBank Albania

Lloji i kredisë: Kredi Hipotekore “Overdraft/kredi hipotekare”

Kohëzgjatja e kredisë:

Vlera e kredisë:

Njësia monetare:

Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues:

Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat:

Norma efektive e interesit:

Indeksi orientues/norma referencë:

Marzhi:

Të ardhurat mujore (bruto/neto) të huamarrësit në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit):

Tabelë 1: Kësti i kredisë dhe raporti i vlerës së kështit të kredisë ndaj të ardhurave (në %), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit. - Bashkëngjitur

Shembull i kështit të kredisë dhe raporti i vlerës së kështit të kredisë ndaj të ardhurave (%), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit. Rasti kur kredia jepet në EUR dhe të ardhurat janë në LEK				
Skenari	Vlera e kështit e shprehur në monedhën e kredisë (eur) Kësti: 200 (a)	Kundërvlera e kështit në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat (leke) (b)	Të ardhurat (mesatare mujore të 3 viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen (leke) (c)	Raporti i vlerës së kështit ndaj të ardhurave (d) = (b)/(c)
Kursi i këmbimit nuk ndryshon (kursi Eur/Lek në datën e marrjes së informacionit për kredi)	130	26 000	90 000	28.8%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 5% (i supozuar në të ardhmen)	137	27 400	90 000	30.44%
Nënçmim i kursit të këmbimit me 20% (i supozuar në të ardhmen)	156	31 200	90 000	35%

Klienti ka të drejtë të kërkojë nga Banka konvertimin/kthimin e kredisë me kufi në një kredi me afat, me kusht që kjo kërkesë të paraqitet jo më vonë se tre (3) muaj përpara datës së maturimit të afatit të kredisë me kufi. Pas kalimit të këtij afati, klienti humbet të drejtën për të kërkuar konvertimin e balansës debitorë në një kredi me afat dhe Banka nuk ka detyrimin të pranojë një kërkesë të tillë të paraqitur jashtë këtij afati.

Kredia me kufi duhet të shlyhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të fundit të afatit të saj, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë. Gjatë kësaj periudhe, deri në shlyerjen e plotë të detyrimit, klienti nuk gëzon të drejtën për të përdorur më tej kredinë me kufi, si edhe asnjë shumë që mund të kalojë në llogarinë rrjedhëse, pas fillimit të kësaj periudhe, e cila mund të përdoret nga Banka për shlyerjen e kredisë me kufi dhe të komisioneve përkatëse. Palët kanë të drejtë të rinegociojnë kushtet e kredisë me kufi, përfshirë afatin dhe termat e saj, deri në dy (2) muaj përpara datës së mbylljes së kësaj kredie.

DEKLARATË PËLQIMI MBI PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA AUTORITETI I KONKURENCËS

Në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Fibank Albania sh.a. (në vijim “Banka”) informon se, në rastet e parashikuara nga ligji dhe në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj, informacioni dhe dokumentacioni që lidhet me marrëdhënien e kreditimit mund t’i vihet në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës (në vijim “Autoriteti”) në kuadër të aktiviteteve të monitorimit, hetimeve paraprake ose hetimeve të thelluara.

Ky dokumentacion mund të përmbajë të dhëna personale të kredimarrësit, garantuesve, përfaqësuesve ligjorë dhe personave të tjerë të lidhur me marrëdhënien kontraktore. Autoriteti mund të aksesojë dhe përpunojë këto të dhëna vetëm në masën e nevojshme për ushtrimin e kompetencave të tij ligjore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Banka ka detyrimin ligjor të vërë në dispozicion të Autoritetit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, ndërsa Autoriteti do t’i përpunojë të dhënat vetëm për qëllimet e përcaktuara me ligj.

Pasi u informova mbi qëllimin e përpunimit, bazën ligjore dhe të drejtat e mia në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale:

- Jap pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga Autoriteti i Konkurrencës.
- Nuk jap pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga Autoriteti i Konkurrencës.

Konsumatori/ët

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Data e nënshkrimit

(____/____/20____)